



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 295/4 prot.

Tiranë, më 04 . 07 .2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

**TË VENDIMIT NR. 295/2, DATË 05.07.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASI Z. QAZIM JAKUPI, PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR PËR ÇËSHTJEN”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e z. Qazim Jakupi, Administrator i Shoqërisë “Treveshina”, sh.p.k, me nr. 351 prot, datë 29.01.2021, ndaj veprimtarisë gjyqësore të ish-magjistrates znj. E.Ll., ish-gjyqtare në Gjykatën e Apelit, Tiranë dhe me vendimin nr. 295/2 datë 05.07.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për përfundimin e procedurës së verifikimit të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi z. Qazim Jakupi, pa një vendim përfundimtar për çështjen”, bazuar në nenin 95, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesave. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqënëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Përmet, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Lagjja e Re, Rruga: “Treveshina”, sh.p.k, Përmet;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



Dëshira Pasko